



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2021:043438  
Datë: 18.03.2024  
Numri i dokumentit: 05467153

C.nr.201/21

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, Gjyqtari Izet Gërguri, në çështjen juridike të paditësit B.B të cilin e përfaqëson av.V.K nga Vushtrria, kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë, lidhur me kompensim shujtave gjatë ditëve të pranisë në punë, jashtë seance, në pajtim me nenin 399 të LPK-së, me datën 18.03.2024, e mori dhe e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I.REFUZOHET e pa bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit B.B me të cilën ka kërkuar kompensimin e ushqimit (shujtave) gjatë ditëve të punës nga data 01.01.2016 apo 44 euro në muaj, me kamatë prej 8 % duke llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë me datën 08.03.2021 e gjerë në pagesen definitive të detyrimit si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

II.Secila palë bart shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësi në këtë gjykatë ka paraqit padi, me të cilën kanë kërkuar kompensimin e shujtave (ushqimit) gjatë ditëve të punës dhe kompensimin e gjatë ditëve të punës nga data 01.01.2016 apo 44 euro në muaj, me kamatë prej 8 % duke llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë me datën 08.03.2021 e gjerë në pagesen definitive të detyrimit si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, bazuar në Vendimin e Kuvendit Komunal në Vushtrri të datës 29.07.2010. Ka shtuar se paditësi është zyrtar i gjendjes civile dhe se e paditura nuk ia ka kompensuar shujtat gjerë më tani edhe pse paditësi ka kërkuar nga e paditura.

Gjykata ia ka dërguar të paditues aktvendimin për përgjigje në padi, ndërsa e paditura ka paraqitë përgjigje në padi duke e kundërshtuar kërkesën e paditëses me arsyetimin se vendimi mbi të cilin e paditura e mbështet kërkesën e saj nuk është i protokolluar dhe as nënshkruar asnjëherë nuk ka hyrë në fuqi. Ka theksuar se nuk ka mbështetje kjo padi në asnjë dispozitë ligjore apo nënligjore e cila ua njeh nënpunësve civil këtë të drejtë. Ka propozuar refuzimin e kërkesëpadiës së paditësit.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi dhe njoftimit të të paditues, ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 399 të LPK-së, për refuzimin e kërkesëpadiës së paditësit jashtë seance, pasi që: nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, pra Kërkesëpadia është e pathemeltë, sepse qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi dhe se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi.

Nga përgjigja në padi dhe shkresa e MPL – së me seli në Prishtinë, gjykata është njoftuar se Vendimi i Kuvendit Komunal të Vushtrrisë i datës 29.07.2010 mbi të cilin e mbështet paditësi kërkesën e tij, nuk është i nënshkruar dhe as protokolluar, i njëjti nuk e ka marrë vlerësimin e ligjshmërisë nga ana e MAPL, si autoritet mbikqyrës i Komunave të Republikës së Kosovës.

Sa i përket Vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me datë 29.07.2010, në bazë të të cilit paditësi e mbështet kërkesëpadinë e tij për kompensimin e shujtave, fillimisht vlen të theksohet se Ligji Nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative, i cili ishte në fuqi në kohën e nxjerrjes së, neni 84 par.2 shkronja j), në mes të tjerave përcaktonte: se akti administrativ duhet të përmbajë edhe nënshkrimin e udhëheqësit të organit të administratës publike që nxjerr aktin ose të drejtuesit të organit kolektiv.

Neni 12 i Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, përcakton se “12.1 kuvendi i komunës mund të miratojë akte brenda fushës së kompetencave të tij. 12.2 Aktet e kuvendit të komunës vlejné në territorin e komunës që ka miratuar aktin. Këto akte përfshijnë: a) statutin e komunës; b) rregulloren e punës; c) rregulloret komunale; dhe d) çdo akt tjetër të nevojshëm apo të duhur për funksionim efikas të komunës”.

Neni 41 par 5 i Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Nr.58/11 i datës 28.04.2011, i cili ishte në zbatim në kohën e nxjerrjes së Vendimit për kompensimin e shujtave të datës 29.07.2010, përcaktonte se Aktet e Kuvendit të Komunës hyjnë në fuqi tetë ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës. Kur Kuvendi i Komunës konsideron se është me interes, një akt i kuvendit të komunës mund të hyjë në fuqi në ditën e miratimit.

Tutje, neni 31 par 5 i Rregullores (KKV) nr.05/2023 për Punën e Kuvendit, e miratuar nga Kuvendi Komunal i Vushtrrisë me datë 27.07.2023, përcakton se Aktet e miratuara nga Kuvendi i Komunës i nënshtrohen procedurës së shqyrtimit të detyrueshëm të detyrueshëm të ligjshmërisë, përpos akteve të cilat me Udhëzim Administrativ të MPL-së, janë përjashtuar nga ky proces.

Neni 8 par 1. i Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, përcakton se “Aktet e kuvendit të komunës, që i nënshtrohen shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë janë: pika 1.3. Vendimet e përgjithshme të kuvendit të komunës”, ndërsa par.3 i këtij neni përcakton se 3. Aktet të cilat nuk dërgohen nga komuna për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë, nuk prodhojnë efekt juridik.

Nisur nga të gjitha dispozitat e lartcekura ligjore, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit për kompensimin e shujtave duhet të refuzohet si e pa bazuar, marrë parasysh faktin se paditësi ka pretenduar se themelësia e kërkesëpadisë së tij del nga Vendimi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë i datës 29.07.2010, i dorëzuar si provë nga paditësi, e i cili nuk është i nënshkruar dhe për të cilin nuk është dhënë vlerësimi i ligjshmërisë nga autoriteti kompetent (Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, e që në këtë rast ky Vendim nuk mund të prodhojë ndonjë efekt juridik, ndërsa paditësi nuk i ka ofruar gjykatës prova të tjera për të vërtetuar bazueshmërinë e kërkesëpadisë së tij.

Gjykata konstaton se vendimi në fjalë i dorëzuar nga paditësi si provë, në bazë të të cilit edhe ka pretenduar të drejtën e tij për kompensimin shujtave, nuk ka efekt juridik dhe në këtë rast kërkesëpadia e paditësit e mbështetur në këtë vendim, nuk ka bazë ligjore.

Andaj, marr parasysh të gjitha të lartcekurat, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata, për shpenzimet e procedurës vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në nenin 450 të LPK-së, pasi që pala paditëse e ka humbur kontestin, ndërsa pala e paditur nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës kontestimore.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me nenin 143 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C.nr.201/21, datë: 18.03.2024

Gj y q t a r i  
Izet Gërguri

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa ushtrohet përmes kësaj gjykate.